VENDIM
Nr. 37, datë 30.6.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipë-risë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 5.5.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 9 Akti, që i përket:

KËRKUES: Zaim Rexha

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Dervish Sekniqi, Agim Tufi, Vildan Tufi, Syrri Dizdari, Mensur Nehani, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendi-meve nr. 66, datë 27.2.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipë-risë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi në vitin 1993 ka blerë nga shtetasi H.U. një pronë të paluajtshme, të përbërë nga një sipërfaqe trualli 160 m^2 dhe shtëpia e ndërtuar mbi të, me sipërfaqe 73.9 m^2, të cilën e ka regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 313/1993. Në vitin 2007 ai i është drejtuar Zyrës Vendore për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Shkodër për regjistrimin e pronës në sistemin e ri të regjistrimit. ZVRPP-ja, me aktin nr. 485 prot., datë 2.4.2007, ka vendosur refuzi-min e regjistrimit me arsyetimin se pasuria figu-ronte pa kufij dhe pa sipërfaqe të pronës dhe se kërkuesi nuk dispononte deklaratat e kufitarëve.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi me objekt detyrimin e ZVRPP-së për të regjistruar pasurinë, padi e cila është pranuar pjesërisht me vendimin nr. 1459, datë 28.5.2010.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 66, datë 27.2.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të kërkuesit.

4. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit rekurset e paraqitura nga kërkuesi dhe ZVRPP-ja, me vendimin nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, ka vendosur mospra-nimin me arsyetimin se nuk përmbanin asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.

II

5. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushte-tuese në datën 4.11.2015, duke pretenduar se procesi i zhvilluar në gjykatat e zakonshme nuk ka respektuar standardet që lidhen me procesin e rregullt ligjor, për rrjedhojë atij i është cenuar e drejta e pronësisë. Në mënyrë të përmbledhur kërkuesi parashtron

se është cenuar:

5.1 *E drejta për t'u dëgjuar* dhe për të parash-truar prova e argumente në lidhje me çështjen, pasi Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka respektuar orarin e caktuar me shpallje për zhvillimin e seancën gjyqësore civile.

5.2 *E drejta e aksesit* në Gjykatën e Lartë, pasi ndonëse pretendimet për shkelje procedurale gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Shkodër ishin parashtruar në rekurs, Kolegji Administrativ vendosi mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

5.3 *Parimi i gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi Gjykata e Apelit Shkodër duhet t'i kishte dhënë përparësi koordi-nimit të orarit të publikuar me shpallje me atë të shënuar në dosje, por duke gjykuar të gjitha rrethanat e çështjes, shkelja ka qenë e qëllim-shme.

5.4 *Standardi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm*, pasi edhe pse çështja kishte natyrë administrative jo komplekse, bazë ligjore të qartë, si dhe sjellje aktive të kërkuesve, procesi gjyqësor ka zgjatur gati 10 vjet. Për sa i takon sjelljes së palëve të pa-ditura, ajo nuk ka qenë korrekte, kurse veprimta-ria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka qenë jashtëzakonisht e pakoordinuar, duke kryer veprime procedurale në kundërshtim me thelbin e gjykimit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

6. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushte-tues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushte-tutës, dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tij janë paraqitur brenda afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30/2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipë-risë".

7. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundi-mtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat proce-durale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 48, datë 6.7.2015; nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe atë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ai legjitimohet t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në Gjykatën e Apelit Shkodër

9. Kërkuesi ka pretenduar se mosrespektimi nga Gjykata e Apelit Shkodër i orarit të caktuar me shpallje për zhvillimin e seancën gjyqësore civile dhe zhvillimi i procesit gjyqësor pa praninë e tij, edhe pse ai ka qenë i pranishëm dhe në pritje në ambientet e gjykatës, i ka mohuar të drejtën për të mbrojtur pretendimet e tij, dhe për të parashtruar prova e argumente në lidhje me interesat e tij ligjorë në çështjen konkrete.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkre-tisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendim-marrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në

kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 31, datë 26.5.2014; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për efekte të këtij gjykimi, veçanë-risht referuar listës së shpalljes së çështjeve për shqyrtim në muajin shkurt 2012 nga Gjykata e Apelit Shkodër, rezulton se seanca gjyqësore civile ishte caktuar të zhvillohej në orën 9:30. Po ashtu, Gjykata vëren se në kapakun e dosjes gjyqësore si orë të zhvillimit të seancës është shënuar me shkrim dore ora 9:00, kurse sipas procesverbalit të seancës konstatohet se ajo ka filluar në orën 9:18 dhe ka përfunduar në orën 9:25. Në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 27.2.2012 pasqyrohet fakti se kërkuesi (edhe disa nga personat e tretë) u thirr dhe nuk u paraqit, prandaj gjykata ka vendosur ta zhvillojë gjykimin e çështjes në mungesë të tyre, duke qenë se ata kanë marrë dijeni për ditën dhe orën e gjykimit me shpallje dhe pa ndonjë shkak të ligjshëm nuk janë paraqitur. Po ashtu, Gjykata vëren se gjatë seancës gjyqësore është lexuar fillimisht kërkesa ankimore e paraqitur nga pala e paditur, ZRPP-ja, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, më pas procesi ka vijuar me leximin e ankimit dhe apelit kundërshtues të kërkuesit, dhe në përfundim gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që kishte pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, duke urdhëruar ZRPP-në të regjistronte një pjesë të pasurisë që nuk krijonte mbivendosje.

13. Gjykata, bazuar në rrethanat e mësipërme, vlerëson se Gjykata e Apelit Shkodër, duke zhvilluar seancën gjyqësore në një orar të ndryshëm nga ai i njoftuar kërkuesit sipas listës së shpalljes, i ka cenuar këtij të fundit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Gjykata çmon se thjesht dhe vetëm leximi nga Gjykata e Apelit Shkodër i përmbajtjes së ankimit dhe apelit kundërshtues të paraqitur nga kërkuesi nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar të përmbushur detyrimin që buron nga parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Gjykata rithekson se thjesht prania fizike e palëve gjatë procesit civil nuk është e mjaftueshme, sepse është gjyqtari që gjatë gjykimit që duhet t'u japë mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre.

14. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundi-min se për sa kohë kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm në seancën gjyqësore, për shkak të zhvillimit të saj në një orar të ndryshëm nga ai i njoftuar zyrtarisht me shpallje, pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i bazuar.

15. Gjykata rithekson se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të

Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 5, datë 25.2.2013; nr. 42, datë 7.7.2014; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata e ka vlerësuar si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rastin kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata, në vështrim të standardeve të mësipërme, po ashtu nisur nga përfundimi për mosgarantimin e barazisë substanciale të palëve nëpërmjet një kontradiktoriteti efektiv midis tyre në procesin gjyqësor civil të zhvilluar nga Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se kjo parregullsi nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë, vlerëson se kjo e fundit ka lejuar cenimin e aksesit për kërkuesin. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e procesit të rregullt në Gjykatën e Lartë është i bazuar.

18. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, që lidhen me cenimin e parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme, si dhe me mosgjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata vlerëson se ato nuk janë ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë kërkuesi nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues në lidhje me to.

19. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretë-ndimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kush-tetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushte-tutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 66, datë 27.2.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë[1].
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo

[1] Gjyqtarët V. Kristo dhe F. Lulo votuan vetëm për shfuqizimin e vendimit nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.